



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1208/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Brikenda Sharapolli kandidate për anëtare të kuvendit komunal nga radhët e PDK-së në Pejë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të manipulimit me vota, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Brikenda Sharapolli, kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Pejë, nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 15:16 nga kandidatja për anëtare të kuvendit komunale nga radha e PDK-së Brikenda Sharapolli, ku ka pretenduar se janë bërë manipulime nga KQZ-ja në këto vendvotime nr: 1704X/03R, nr:1703C/01R ,nr:1701/03R, thuhet në pretendimet e ankuesit. Parashtruesi i ankesë ka bashkangjitur disa formularë të rezultateve të kandidatit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore të kandidates për anëtare të kuvendit komunal nga radha e PDK-së Brikenda Sharapolli janë të pa argumentuara në fakte dhe dëshmi konkrete pasi qe ankesës në fjalë nuk i ka bashkangjitur dëshmi bindëse, për tu vërtetuar për shkeljen e supozuar andaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1208/2013 më datën 06.12.2013.



**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**

Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.